

INFORMACIONE BAZË PËR APLIKANTËT PËR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE NË GREQI

Aplikant për mbrojtje ndërkombëtare është i huaji ose personi pa shtetësi, i cili deklaron gojarisht ose me shkrim para kujt do autoriteti grekë që kërkon azil ose kërkon të mos dëbohet sepse ka frikë përndjekjeje për shkak të rracës, fesë, kombësisë, pjesëmarrjes në grupe të veçanta shoqërore apo të bindjeve politike, ose sepse rrezikohet të pësojë dëmtim të rëndë në vendin e origjinës ose të qëndrimit të mëparshëm të tij, sepse rrezikohet me dënim me vdekje apo ekzekutim, me tortura apo trajtim çnjerëzor e poshtërues, ose sepse rrezikohet jeta dhe integriteti i tij për arsye të konflikteve ndërkombëtare apo luftrave civile.

Aplikant për mbrojtje ndërkombëtare konsiderohet dhe i huaji, që hyn në Greqi sipas Rregullores së «Dublin-it»¹.

Aplikimi për mbrojtje ndërkombëtare : Ku dhe si e depozitoni?

- Autoritetet kompetente për të paraqitur kërkesën tuaj janë Zyrat Rajonale të Azilit dhe njësitë e Zyrave Rajonale Të Azilit

KUJDES

Ju informojmë se Shërbimi i Azilit nuk është kompetent të marrë në dorëzim kërkesën tuaj nëse:

a) keni dorëzuar kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në Polici, e cila është në procedurën e shqyrtimit, b) keni në zotërimin tuaj kartën e veçantë për aplikantin e huaj azilkërkues (kartën roz).

Gjithashtu, ju informojmë se në çdo rast do t'ju merren shënjat e gishtave në mënyrë që Shërbimi i Azilit të vërtetojë ndërkohë nëse keni aplikuar kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, kështu do të vërtetohet menjëherë nëse është në procedurë kërkesa juaj në fjalë.

- Në qoftë se jeni i arrestuar ose qëndroni në Qendra Pritje dhe Identifikimi (QPI), autoritetet kompetente të arrestit ose të Pritjes do të informojnë Shërbimin e Azilit për dëshirën tuaj për të aplikuar kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.
- Duhet të aplikoni kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare personalisht, me gojë ose me shkrim. Mund të aplikoni dhe për anëtarë të familjes suaj nëse këta janë me ju në Greqi dhe e dëshirojnë diçka të tillë. Bashkë me ju, duhet të vijnë edhe ata (anëtarët e familjes) dhe të paraqiten në Shërbimin e Azilit
- Kur paraqisni aplikimin, nëse ju nuk mundeni të kuptoheni me nëpunësin e Shërbimit të Azilit, ju bëjmë të ditur se do të ketë përkthyes që do t'ju ndihmojë.
- Kur dorëzimin e aplikimit tuaj duhet t'u përgjigjeni me sinjeritet të plotë pyetjeve të nëpunësit. Nëse dorëzoni të dhëna ose dëshmi të pavërteta, kjo do të ndikojë negativisht në gjykimin e çështjes tuaj.
- Në qoftë se jeni minoren i pashoqëruar, domethënë jeni nën moshën 18 vjeç dhe nuk shoqëroheni nga një i rritur përgjegjës për kujdesin tuaj, në bazë të legjistacionit ose praktikës greke, autoritetet duhet që të informojnë menjëherë Prokurorin kompetent. Prokurori do t'ju caktojë një përfaqësues (Kujdestar) i cili do të ketë përgjegjësi për ju dhe do të mbrojë interesat tuaja. Nëse jeni nën 15 vjeç për kërkesën tuaj për mbrojtje ndërkombëtare duhet të aplikojë përfaqësuesi që ju është caktuar. Nëse jeni mbi 15 vjeç mund të depozitoni vetë aplikimin tuaj. Autoritetet do të kujdesen për mbrojtjen dhe mbajtjen tuaj në një ambient të përshtatshëm për të mitur.

¹ Vendet që aplikojnë Rregulloren "Dublin III" janë: Austria, Belgjika, Bullgaria, Franca, Gjermania, Danimarka, Zvicra, Estonia, Mbretëria e Bashkuar, Irlanda, Islanda, Spanja, Italia, Qiproja, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania, Luksemburgu, Malta, Norvegjia, Holanda, Hungaria, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Suedia, Çekia, Finlanda.

- Kur të aplikoni për mbrojtjen ndërkombëtare, do të fotografoheni dhe do t'ju merren shënjat e gishtave, juve si dhe antarëve të familjes suaj që janë mbi 14 vjeç. Shenjat e gishtave do të futen në Bazën Qendrore Europiane të EURODAC dhe, në qoftë se ju keni aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në një tjetër vend Evropian, i cili zbaton Rregulloren e "Dublin III", do të transferoheni atje që të shqyrtohet atje kërkesa juaj.
- Do të duhet të dorëzoni dokumentet tuaja të udhëtimit (pasaportë) ose çfarëdo dokumenti tjetër që keni në zotërim, i cili ka të bëjë me shqyrtimin e aplikimit dhe identifikimin tuaj dhe të anëtarëve të familjes suaj, vendin nga keni ardhur dhe vendin e origjinës tuaj, si dhe gjëndjen tuaj familjare.
- Mund t'i nënshtroheni kontrollit trupor ose kontrollit të sendeve tuaja. Mund t'u nënshtroheni analizave mjekësore.
- Shërbimi i Azilit do t'ju vendosë një datë për intervistë dhe do të merrni kartën e kërkuesit të mbrojtjes ndërkombëtare që mund të jetë fuqi deri në gjashtë muaj. Këtë kartë duhet ta keni gjithmonë me vete.
- Kur të aplikoni autoritetet kompetente janë të detyruara t'ju informojnë në një gjuhë që ju kuptoni për procedurën, të drejtat dhe detyrimet tuaja si aplikant mbrojtjeje ndërkombëtare, si dhe për afatet që janë në fuqi gjatë procesit.
- Nëse jeni viktimë torturash, përdhunimi ose aktesh të tjera të rënda dhune, duhet të informoni Autoritetet, me qëllim që t'ju ndihmojnë.
- Mund të kërkonti të komunikoni me Komisionin e Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët, ose organizata që sigurojnë ndihmë juridike, mjekësore dhe psikologjike.
- Gjatë procesit keni të drejtë të kërkonti ndihmën e një avokati ose këshilltari tjetër të pëlqimit tuaj (pa ndërmjetsimin e Shërbimit të Azilit). Pagesa dhe shpenzimet e një avokati apo këshilltari tjetër do të rendojnë mbi ju.
- Nëse dëshironi, mund t'ju jepet një periudhë e shkurtër kohe për t'u përgatitur siç duhet për intervistën dhe të konsultoheni me avokat ose këshilltar që t'ju ndihmojë gjatë procedurës.
- Në çdo rast, ju mund të kërkonti që intervista dhe përkthimi të bëhen nga nënpunës i gjinisë që ju dëshironi, nëse keni arsye serioze për këtë gjë. Kërkesa në fjalë do të shqyrtohet nga Shërbimi dhe do të plotësohet nëse egziston kjo mundësi.
- Në rast se jeni i mitur i pashoqëruar, duhet të informoheni nga përfaqësuesi juaj për intervistën. Përfaqësuesi juaj do të jetë ftuar dhe mund t'ju shoqërojë në intervistë. Autoritetet mund t'ju bëjnë analiza mjekësore për të përcaktuar moshën tuaj. Për këtë proces duhet të informoheni ju dhe përfaqësuesi juaj dhe duhet të bini dakord ju ose përfaqësuesi juaj.

Dorëheqja dhe anullimi i kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare

- Keni mundësi kur të dëshironi, të hiqni dorë nga aplikimi juaj. Duhet të paraqiteni personalisht në Zyrën Rajonale të Azilit dhe të bëni dorëheqjen me shkrim. Në rast se ju jepni dorëheqje Shërbimi nuk do të shqyrtojë kërkesën tuaj dhe ju duhet të largoheni nga vendi, përderisa nuk jeni zotëruar i ndonjë statusi tjetër qëndrimi.
- Shërbimi i Azilit mund të konsiderojë se nuk jeni të interesuar për të vazhduar shqyrtimin e aplikimit tuaj (anullim i heshtur i kërkesës) dhe të ndërpresë shqyrtimin:
 - a) nëse refuzoni të jepni informacione me rëndësi që ju janë kërkuar nga autoritetet për aplikimin tuaj, ose
 - b) në qoftë se ju nuk shkoni në intervistë, ose
 - c) në qoftë se arratiseni nga arresti, ose
 - d) në qoftë se nuk zbatoni detyrimet që ju janë imponuar nga policia përkundrejt arrestit tuaj, ose

- e) në qoftë se largoheni nga banesa në të cilën ju kanë vendosur autoritetet pa i informuar ato, ose
- f) në qoftë se largoheni nga shteti pa kërkuar leje nga Shërbimi i Azilit, ose
- g) në qoftë se nuk e informoni menjëherë Shërbimin e Azilit kur ndryshoni adresën tuaj dhe të dhënat e kontaktit me ju, ose
- h) në qoftë se nuk kontaktoni me Shërbimin e Azilit kur ju kërkohet kjo gjë, ose
- i) në qoftë se nuk shkoni për të rinovuar kartën tuaj e shumta një ditë pune më vonë nga afati i skadimit të saj.

Në rast se Shërbimi i Azilit ndërpret shqyrtimin e aplikimit tuaj, ju keni të drejtë të kërkoni vazhdimin e shqyrtimit prej tij. Ju duhet të shkoni në Shërbimin e Azilit për të shpjeguar arsyet për të cilat Shërbimi i Azilit gabimisht konsideroi se ju nuk ju intereson aplikimi juaj. Shërbimi do të vendosë në lidhje me këtë gjë. Nëse Shërbimi refuzon kërkesën tuaj keni të drejtë të ushtroni apelim.

Procedura e shqyrtimit të aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare

- Ditën që ju është përcaktuar nga Shërbimi i Azilit, do të jepni intervistë para nënpunësit të Shërbimit të Azilit. Ju duhet t'u përgjigjeni me sinqeritet të plotë pyetjeve të tij, të depononi në mënyrë të hollësishme vetëm fakte të vërteta dhe të mos fshihni asnjë informacion që ka lidhje me kërkesën tuaj. Nëse do të paraqisni dëshmi ose fakte të pavërteta kjo do të ndikojë negativisht në shqyrtimin e aplikimit tuaj.
- Nëpunësi i Shërbimit të Azilit do t'ju pyesë gjatë intervistës veçanërisht për të dhënat që ju përmendni në aplikimin tuaj, të dhënat e identitetit tuaj, për mënyrën se si keni ardhur në Greqi, për arsyet që ju bënë të largoheni nga vendi juaj i origjinës ose vendi ku qëndronit, nëse jeni pa shtetësi, si dhe për arsyet për të cilat ju nuk mund ose nuk dëshironi të ktheheni më aty. Gjatë intervistës ju mund të shtoni informacione të tjera që i konsideroni të nevojshme.
- Në qoftë se, për shkak të gjuhës, ju nuk mund të komunikoni me nëpunësin e Zyrës për Azil, në intervistë do të jetë i pranishëm edhe një përkthyes.
- Në intervistë ju mund të shkoni bashkë me një avokat ose një këshilltar tjetër (ligjor, mjekësor, mjek psikolog ose punonjës social).
- Çfarëdo që të thoni në intervistë do të jetë në besueshmëri.
- Intervista juaj mund të inçizohet. Nëse intervista nuk inçizohet, nënpunësi do të përpilojë një tekst (proçesverbal), që do të përfshijë të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e intervistës. Në këtë rast ju duhet të kontrolloni tekstin e proçesverbalit me ndihmën e përkthyesit, të konfirmoni përmbajtjen e tij ose të kërkoni të bëhen korrigjime dhe së fundi ta nënshkruani atë. Në rast se dëshironi keni mundësinë të merrni një kopje të proçesverbalit apo të raportit të hartuar si dhe të inçizimit të intervistës suaj.
- Pas intervistës Shërbimi i Azilit do të vendosë për t'ju dhënë statusin e refugjatit ose të përfituesit të mbrojtjes të përkohshme ose të refuzojë kërkesën tuaj.
- Me daljen e vendimit të kërkesës suaj, Shërbimi i Azilit do t'ju njoftojë që ta merrni atë në dorëzim. Do të njoftoheni në bazë të të dhënave të kontaktit që keni deklaruar ose me telefonatë, ose me letër apo telegram, ose faks, ose e-mail.
- Zyra e Shërbimi të Azilit duhet t'ju dorëzojë vendimin me ndihmën e një përkthyesi në gjuhën që ju kuptoni.

Detyrimet e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare

Si aplikues i statusit për mbrojtje ndërkombëtare në Greqi, keni këto detyrime:

- Të qëndroni në Greqi deri sa të përfundojë shqyrtimi i kërkesës suaj.
- Të bashkëpunoni me autoritetet greke për çdo çështje që lidhet me aplikimin tuaj dhe verifikimin e të dhënave mbi identitetin tuaj.

- Të paraqiteni personalisht në Shërbimin e Azilit për të rinovuar kartën tuaj para skadimit dhe jo më vonë se e shumta një ditë pune më vonë nga data e skadimit të saj.
- Të informoni menjëherë Shërbimin e Azilit për adresën tuaj dhe të jepni të dhënat e kontaktit me ju, si dhe çfarëdo ndryshimi të tyre. Zyra e Azilit do të dërgojë në adresën që ju keni deklaruar dokumenta që kanë lidhje me kërkesën tuaj.
- Të respektoni afatet që ju janë caktuar në fazat e ndryshme të procedurës së shqyrtimit të aplikimit tuaj.
- Të pasqyroni gjëndjen tuaj të vërtetë ekonomike në rast se merrni ndihma nga Shteti. T'u bindeni detyrimeve që parashtrihen në rast se banonij në Qendra Pritjeje ose në vende të tjera.

Të drejtat e aplikuesve për mbrojtje ndërkombëtare

Si aplikues për mbrojtje ndërkombëtare në Greqi:

- Ndalohet të dëboheni deri sa të mbarojë shqyrtimi i aplikimit tuaj.
- Mund të qarkulloni i lirë në vend, përveç rastit kur në kartën që keni marrë, përcaktohet një zonë e caktuar e vendit në të cilën nuk lejohet të qarkulloni.
- Nëse nuk keni strehim mund të kërkonti të strehoheni në Qëndër Strehimi ose në tjetër vend.
- Keni të drejtë të punoni në bazë të kushtëzimeve që përcakton legjislacioni grek.
- Keni të njëjtat të drejta dhe detyrime siguracioni, si i punësuar, që ka dhe çdo qytetar grekë.
- Keni falas kujdesin mjekësor, farmaceutik dhe spitalor, nëse nuk keni siguracion ose jeni pa të ardhura.
- Fëmijët tuaj gëzojnë të drejtën – dhe ju nëse jeni i mitur- e shërbimit arsimor falas.
- Keni të drejtën e trajnimit profesional.
- Nëse jeni person me shkallë invaliditeti 67% e lart, keni të drejtën të merrni ndihmë invaliditeti, nëse nuk është i mundur qëndrimi juaj në një Qëndër Pritjeje.
- Si aplikant i mbrojtjes ndërkombëtare **nuk** mund të udhëtoni jashtë Greqisë.
- Si aplikant i mbrojtjes ndërkombëtare **nuk** mund të sillni në Greqi familjen tuaj nga vendi juaj i origjinës.

E drejta për apelim dhe shqyrtimi në shkallën e dytë

- Nëse kërkesa juaj refuzohet, ose ju është dhënë statusi për mbrojtje të përkohshme, (subsidiare) dhe mendoni se meritoni statusin e refugjatit, keni të drejtë të ushtroni apelim përballë Organeve të Apelit. Ju duhet të dorëzoni apelimin tuaj në Zyrën Rajonale të Azilit ose në njësinë e Zyrave Rajonale të Azilit e cila ju dorëzoj vendimin brenda afatit që përmendet në vendimin që morët në dorëzim.
- Ky afat fillon nga dita e nesërme e marrjes në dorëzim të vendimit nga ju. Nëse për çfarëdolloj arsyeje vendimi nuk ju është dorëzuar, afati për të ushtruar apelim është 60 ditë nga data e skadimit të kartës suaj ose nga marrja e vendimit, sipas rastit.
- Apeli juaj do të shqyrtohet nga një Komision Apelit. Komisioni i Apelit zakonisht shqyrton apelimet në bazë të të dhënave të dosjes dhe nuk ju fton për intervistë. Por, do të informoheni për datën e shqyrtimit të apelim tuaj, si dhe se kur ju mund të dorëzoni, nëse dëshironi, materiale shtesë të cilat do të merren parasysh nga Komisioni i Apelit.
- Keni mundësinë, për sa kohë është në procedurë kërkesa juaj për apel, të jepni dorëheqjen nga ajo. Duhet të paraqiteni personalisht në Zyrën Rajonale të Azilit ku apeluat dhe të jepni dorëheqjen me shkrim. Nëse ju jepni dorëheqjen, apeli juaj nuk do të shqyrtohet dhe do të duhet të largoheni nga vendi, përderisa nuk keni ndonjë statusi tjetër qëndrimi.

- Komisioni i Apelit mund të konsiderojë se juve nuk ju intereson të vazhdoni shqyrtimin e apelit tuaj (anullim i heshtur) dhe të nderprese shqyrtimin e tij:
 - a) nëse refuzoni të jepni informacione me rëndësi të madhe për aplikimin tuaj të cilat ju janë kërkuar nga Autoritetet, ose
 - b) në rast se arratiseni nga vendi i arrestit, ose
 - c) në rast se nuk zbatoni detyrimet që ju janë imponuar nga Policia përkundrejt arrestit tuaj, ose
 - d) në rast se largoheni nga vendi i qëndrimit që ju kanë përcaktuar autoritetet pa i informuar ato, ose
 - e) në rast se largoheni nga vendi pa kërkuar leje nga Shërbimi i Azilit, ose
 - f) në rast se nuk e njoftoni menjëherë Shërbimin e Azilit kur ndryshoni adresën tuaj dhe të dhënat e kontaktit me ju, ose
 - g) në rast se nuk kontaktoni me Komisionin e Apelit kur ju kërkohet kjo gjë, ose
 - h) në rast se nuk paraqiteni për të rinovuar kartën tuaj e shumta një ditë pune pas afatit të skadimit të saj.
- Nëse Komisioni i Apelit vendos që t'ju ftoj për intervistë do të informoheni jo më vonë se pesë (5) ditë pune përpara datës së intervistës. Ju keni të drejtë të paraqiteni në Komisionin e Apelit me avokat ose këshilltar tjetër. Edhe nëse ju nuk paraqiteni në Komisionin e Apelit, apelimi juaj do të shqyrtohet normalisht.
- Komisioni i Apelit do të vendosë nëse do t'ju japë statusin e refugjatit ose përfituesit të mbrojtjes të përkohshme(subsidare), ose do të refuzojë apelin tuaj.
- Për të marrë në dorëzim vendimin e Komisionit të Apelit procedura është e njëjtë me procedurën për marrjen në dorëzim të vendimit nga Shërbimi i Azilit.
- Nëse apelimi juaj refuzohet, ose ju jepet statusi i mbrojtjes së përkohshme, (subsidiare) por ju pretendoni se meritoni statusin e refugjatit, mund të ushtroni kërkesë anulimi në Gjykatën kompetente. Kërkesa për anulim nuk ka karakter pezullues të menjëhershëm, domethënë lë të mundshëm largimin tuaj nga vendi.

Mbajtja në arrest e aplikantëve për mbrojtje ndërkombëtare

Duhet të dini se :

- Aplikanti për mbrojtje ndërkombëtare nuk mund të mbahet në arrest vetëm me arsyen e hyrjes dhe qëndrimit në mënyrë të paligjshme në vend.
- Nëse aplikoni për mbrojtje ndërkombëtare ndërsa mbaheni në arrest sepse keni kryer shkelje penale, do të vazhdoni të mbaheni në gjëndje arresti.
Nëse aplikoni për mbrojtje ndërkombëtare ndërsa mbaheni në arrest për arsye se hytë në mënyrë të paligjshme në vend ose sepse procedohet largimi juaj nga vendi, mund, përderisa Policia e gjykon se në rastin tuaj nuk mund të jenë në fuqi masa të tjera, të vazhdoni të qëndroni në gjëndje arresti:
 - i. për t'u vërtetuar të dhënat e identitetit tuaj, ose të prejardhjes tuaj, ose
 - ii. në mënyrë që të parapërcaktohen të dhënat në të cilat bazohet kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare, zotërimi i të cilave do të ishte në rast tjetër i pamundur, sidomos kur ekziston rreziku i largimit.
 - iii. në rast se vërtetohet se ka arsye të fuqishme të konsiderohet se kerkuesi ka depozituar kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, me qëllim që thjesht të vonojë ose të pengojë zbatimin e vendimit të kthimit të tij
 - iv. përderisa përbeni rrezik për sigurinë kombëtare ose për rendin publik
 - v. kur ekziston rrezik serioz largimi pa leje, sipas përcaktimit të Rregullores (BE) nr.604/2013, me qëllim që të sigurohet zbatimi i procedurës së transportit në bazë të rregullores së mësipërme.

- Policia Greke mund të vendosë t'ju mbajë në arrest, edhe nëse ju nuk jeni i burgosur, kur gjykon se nuk mund të marrë masa të tjera ndaj jush përveç arrestit, në emër të sigurisë kombëtare ose ruajtjes së rendit publik.
- Mbajtja juaj në arrest mund të zgjasë nga 45 dite deri në 18 muaj në varësi nga arsyeja pse u mbajtët.
- Për mbajtjen tuaj në arrest vendos Drejtori i Policisë, i cili duhet që në vendimin e tij të shpjegojë në mënyrë të hollësishme arsyen përse u vendos arresti juaj.
- Kundër vendimit të mbajtjes në arrest keni të drejtë të paraqisni kundërshtime para Kryetarit ose Magjistratit kompetent të Gjykatës Administrative Rajonale në Rajonin në të cilin mbaheni në arrest.
- Nëse jeni në arrest ose qëndroni në Qendrat e Pritjes dhe Identifikimit, karta e aplikantit të mbrojtjes ndërkombëtare duhet t'ju jepet ditën që do të liheni i lirë, përderisa është në shqyrtim kërkesa juaj. Do të duhet patjetër të shkoni brenda 10 ditëve në Zyrën Rajonale të Azilit dhe të deklaroni të dhënat e kontakti me ju dhe t'ju nxirret e t'ju jepet kartë, në rast se nuk e keni marrë ndërkohë

Faktet të reja thelbësore për aplikim për mbrojtje ndërkombëtare

- **Nëse dalin në dritë fakte të reja të rëndësishme** ose pas refuzimit të apelimit tuaj, ose pas refuzimit të aplikimit tuaj për mbrojtje ndërkombëtare dhe në rast se, ka kaluar data kur mund të bënit apelim, mund të depozitoni aplikim të ri (të mëvonshëm).
- Duhet të depozitoni aplikimin tuaj të mëvonshëm në një nga Zyrrat Rajonale të Azilit ose në njësitë e Zyrrave Rajonale të Azilit. Do të duhet të keni me vete vendimin me të cilin u refuzua aplikimi juaj i parë dhe të depozitoni me shkrim faktet e reja të rëndësishme që dolën në dritë. Pas depozitimit të aplikimit të ri **nuk** do t'ju jepet karta i aplikantit për mbrojtje ndërkombëtare.
- Shërbimi i Azilit do të shqyrtojë faktet e reja që do të depozitoni dhe do të vendosë nëse janë të rëndësishme për aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare.
- Nëse Shërbimi refuzon aplikimin tuaj të mëvonshëm, mund të ushtroni apel në Komisionin e Apelit brenda afatit të pesëmbëdhjetë (15) ditëve. Ky afat fillon që nga dita e nesërme nga ajo që keni marrë në dorëzim vendimin.
- Vetëm në rast se pranohet kërkesa juaj e mëvonshme do t'ju jepet karta e aplikantit për mbrojtje ndërkombëtare dhe do të vazhdojë shqyrtimi i çështjes suaj nga Shërbimi i Azilit.

Do të donim t'ju informojmë se, ndalohet hyrja në ambientet e Shërbimit të Azilit armë, sende me majë ose sende të tjera që mund të përdoren për të shkaktuar plagosje, lënde shpërthyes dhe djegëse, përbërje kimike dhe toksike.
Gjithashtu, do të ndalohet hyrja e personave që mbajnë bagazhe ose çanta, me përjashtim të dosjeve dhe të çantave të vogla të dorës.
Përdorimi i celularëve do të kufizohet vetëm në ambientet e jashtme të Shërbimit të Azilit, ndërkohë që ndalohet çdo marrje fotografie apo video brenda dhe jashtë ambienteve të Shërbimit të Azilit.